



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 75

Prishtinë, më 6.7.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Elheme Hetemi, Ali Lajçi, Zef Morina, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Selvie Halimi.

Mungoi : Branislav Grbić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 15.6.2010,
3. Projektligji për VNM,
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** ku fjalën e kërkoi **Naim Maloku** i cili njoftoi komisionin për nevojën e shqyrtimit të një pike të rëndësishme rreth shpalljes së zonës së veçantë në Prishtinë në vendin e quajtur “Lama e drunjve” sipas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, ngase kjo çështje ka hyrë si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës plenare, për çka komisioni nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 15.6.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Projektligji për VNM

Naser Rugova hapi shqyrtimin rreth projektligjit në fjalë duke filluar leximin e amendamenteve të propozuara. Gjatë debatit për këto amendamente dilema kishte sidomos për nenin 7 (**Naim Maloku, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Naser Rugova, Zef Morina**) ngase me disa paragrafe mund të dyshohet për mundësinë e zhvillimit të kontrabandimit, ndaj

në fund u përmirësua paragrafi 6 ndërsa u fshi paragrafi 7. Gjithashtu debati u zhvillua edhe për nenin 22 dhe 37 ku ceken detyrat e Inspektoriatit, me dilemën a nxjerr vendim inspektori apo jo (**Ali Lajqi, Heset Cakolli, Berat Luzha**). Amendamentet e miratuara ishin si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1

Paragrafi 1, reshti 2, fjala “zbutjen e” zëvendësohet me “**zvogëlimi i**”.

Paragrafi 2, në fillim riformulohet gjuhësisht : “**Ky ligj përcakton rregullimin e procedurave për**”, ndërkaq në vazhdim në reshtin e 8 fshihet “**mëtutje: Ministria**”.

Amendamenti 2

Neni 2

Përkufizimi 1.6 në fjalinë e parë “**Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**” para shkurtesës VNM shtohet me kllapa “**në tekstin e mëtejme : VNM**”, në vazhdim në reshtin e 4 pas fjalës “projektit” shtohet “**në mjedis**”.

Amendamenti 3

Neni 6

Titulli i nenit riformulohet “**Kufizimet në interesin publik dhe individual**”.

Në reshtin e 3 “kufizimeve” bëhet “**kufizime**”, në reshtin e 7 pas fjalës “publik” shtohet “**dhe individual**”.

Amendamenti 4

Neni 7

Paragrafi 6 riformulohet “**Ministria mund të lejoj për rastet e veçanta moskryerjen e VNM për projekte me qëllim të mbrojtjes nacionale, me vendim të Qeverisë**”.

Paragrafi 7, fshihet.

Amendamenti 5

Neni 8

Paragrafi 1, në reshtin e 3 numri 6 bëhet 7.

Amendamenti 6

Neni 9

Në paragrafin 1 fjala “relevant” bëhet “**përkatëse**”.

Amendamenti 7

Neni 12

Në paragrafin 3 fjala “refuzon” zëvendësohet me “**hedh poshtë**”.

Amendamenti 8

Neni 16

Në paragrafin 1 pas fjalës “personi” shtohet “**fizik dhe**”.

Amendamenti 9

Neni 18

Në paragrafin 1 në fund fjalia “**Departamentin për Mbrojtjen e Mjedisit**” zëvendësohet me “**Ministri**” (fjala është për institucion, jo për ministrin si individ).

Amendamenti 10

Neni 19

Në paragrafin 1 në reshtin e 2 shkurtesa “do” zëvendësohet me “**mund**”.

Amendamenti 11

Neni 20

Në paragrafin 1, në reshtin e 3 pas “propozim-vendimi” shtohet “**për pëlqim mjedisor**”, menjëherë në vazhdim fjala “nënshtrohen” bëhet “**nënshtrohet**”.

Në paragrafin 2, në fillim “Planin dhe organizimin e...” riformulohet si vijon : “**Plani dhe organizimi i debatit është përgjegjësi e aplikuesit i cili do të :** ”.

Në paragrafin 2.1, në reshtin e 8 fjala “drafti” zëvendësohet me “**propozim**” (në tërë tekstin e projektligjit fjala “**draft vendimi**” ose “**drafti i vendimit**” zëvendësohet me “**propozim vendimi**”).

Në paragrafin 2.2 në reshtin e 5 fjala “siurimin” zëvendësohet me “**sigurimin**”.

Amendamenti 12

Neni 22

Paragrafi 4.4 riformulohet si vijon :”**këshillat juridike për mjetet e rregullta për ankimim për vlefshmërinë e vendimit dhe procedurat**”.

Amendamenti 13

Neni 23

Në titull fjala “kundërshtim” zëvendësohet me “**ankesë**”.

Amendamenti 14

Neni 24

Paragrafi 3, në fund pas fjalisë “Ankesat e tilla do të bëhen në” shtohet “**ministri dhe**”.

Paragrafi 4 në fillim riformulohet “**Pavarësisht nga**” dhe vazhdon “Neni 22.4...”.

Shtohet paragrafi 5 : “**Çdo procedurë e tillë duhet të jetë e barabartë, e drejtë, në kohë dhe jo aq e shtrenjtë sa të pengoi ushtrimin e sajë**”.

Amendamenti 15

Neni 29

Në paragrafin 5 fjala e fundit të shkruhet me germa të mëdhenj **ESPOO**.

Amendamenti 16

Neni 34

Në fillim shtohet :”**Ministria nëpërmjet inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit...**” vazhdon me “është...”.

Amendamenti 17

Neni 37

Paragrafi 1 riformulohet :”**Inspektori do të përpiloj procesverbalin në të cilin futen konstatimet për gjendjen dhe masat e propozuara. Në bazë të konstatimit Inspektori nxjerr vendim me të cilat ngarkohet personi juridik në përputhje me këtë ligj, për ndërmarrjen e masave**”.

Amendamenti 18

Neni 38

Paragrafi 1, numri 2.500 zëvendësohet me 1.000, ndërkaq në fund numri 20.000 zëvendësohet me **50.000**.

Paragrafi 3, numri 15.000 zëvendësohet me **10.000**, dhe numri 25.000 zëvendësohet me **60.000**.

Amendamenti 19

Neni 39

Paragrafi 1, dymbëdhjetë (12) zëvendësohet me **gjashtë (6)**.

Në fund komisioni miratoi sugjerimet e zyrtarëve të MMPH rreth shtojcave të projektligjit, të cilat do të dërgohen me shkrim nga këta zyrtar dhe do të janë pjesë përbërëse e amendamenteve të lartcekur.

4. Shpallja e zonës së veçantë në vendin e quajtur “Lama e Drunjve”

Pasi që kjo pikë hyri në rendin e ditës në mbledhjen e sotme sipas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, **Naser Rugova** sipas sqarimeve dhe diskutimit të zhvilluar (**Naim Maloku** dhe

pajtimi i komisionit në tërësi), konstatoi se bëhet fjalë për vendimin e Komunës së Prishtinës për interes publik rreth shpalljes së zonës së veçantë në Prishtinë për ndërtimin e dy shkollave dhe institucioneve parashkollore, ndaj komisioni njëzëri nxorri këtë :

R E K O M A N D I M
Për seancën plenare

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës ta miratoi në seancën plenare propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale 3114-1 deri 3125-2 me sipërfaqe prej 90736 m² të vendi i quajtur “Lama e druve”, e cila është në pronësi të IMN Kosova.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,35.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova